

1 E hënë, 2 shtator 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretar i
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Vërej që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit sot.

14 Sot do të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
15 Prokurorisë 04735.

16 Përpara se të fillojmë janë dy aspekte paraprake që duhen
17 trajtuar. Një do të bëhet pa praninë e dëshmitarit.

18 Pikësëpari, Trupi Gjykses vëren se në parashtrimin e
19 protokolluar me F02470, Mbrojtësi i Viktimave njoftoi Trupin
20 Gjykses se synon t'i bëjë pyetje Dëshmitarit 04735. Në
21 parashtrimin e protokolluar F02485, Mbrojtja ka kundërshtuar
22 kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për t'i bërë pyetje këtij
23 dëshmitari. Mbrojtësi i Viktimave iu përgjigj kundërshtimeve
24 të Mbrojtjes.

25 Dhe Trupi Gjykses do të vendosë lidhur me kërkesën e

1 Mbrojtësit të Viktimave pasi të ketë përfunduar Prokuroria me
2 pyetjet e veta të dëshmitarit.

3 Çështjen e dytë dua ta trajtojmë në praninë e
4 dëshmitarit.

5 Fillimisht kalojmë në seancë private për të mbrojtur
6 identitetin e dëshmitarit dhe njëkohësisht sillni dëshmitarin
7 në sallë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, dua të
9 sqaroj pak qëndrimin tonë lidhur me atë që sapo thatë. Ne
10 thamë që mbase do të kemi kundërshtime, por dhe ne po e ruajmë
11 qëndrimin tonë përfundimtar për më vonë, nuk është se e kishim
12 përfundimtar, të paktën nga Mbrojtja e Thaçit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
14 për sqarimin.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7 [Seancë e hapur]

8 SEKRETARI i GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

9 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk dua të bëj parashtrim të

10 shtjelluara se i kemi bërë në shkuarën, por paragrafi 10, 25,

11 27, 31 i Shënimit Përgatitor 1 përmbajnë aspekte që nuk janë

12 në bazë të rregullës 154 dhe përmbajnë dëshmi të reja dhe ne

13 mendojmë që kjo do të kishte qenë në një shënim tjetër

14 përgatitor dhe duhet ta kishte dorëzuar Prokuroria në kohën e

15 duhur diçka të tillë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe ne i kemi dërguar një email

17 sot në mëngjes Trupit Gjykses. Qëndrimi ynë është që paragrafi

18 40 i Shënimit Përgatitor 2 nuk duhet të ishte përfshirë apo

19 nuk duhet trajtuar me dëshmitarin për të nxjerrë dëshmi sepse

20 ne nuk jemi informuar paraprakisht për këto pretendime të

21 ngritura në paragrafin 40. Ne morëm një email nga ZPS-ja ku na

22 konfirmuan që nuk synojnë të nxjerrin dëshmi të reja në bazë

23 të këtij dëshmitari. Prandaj do të dëshiroja që edhe Mbrojtësi

24 i Viktimave në qoftë se do të bëjë pyetje të mos mbështetet

25 tek ky paragraf për të nxjerrë dëshmi të reja.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju
2 Mbrojtësi i Viktimave do të thoni diçka lidhur me këtë
3 dëshmitar, lidhur me këtë paragraf?

4 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
6 atëherë.

7 Sa i takon kundërshtimeve të tjera të gjitha rrëzohen.

8 Dëshmitar, tani do të bëni betimin solemn. Asistentja e
9 seancës të dha betimin solemn. Çohuni në këmbë. Ngrihuni në
10 këmbë ju lutem. Lexojeni atë betimin solemn që keni përpara
11 dhe lexojeni me zë të lartë, ju lutem.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Betimi solemn: Sipas rregullave
13 141(2): I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe
14 përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them
15 të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk
16 do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

17 DËSHMITARI: Imer Imeri

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
19 Dëshmitar. Tani mund të ulesh.

20 Dëshmitar, tani do fillojmë me dëshminë tënde që mendohet
21 se do të zgjasë për afërsisht dy ditë. Siç e dini, fillimisht
22 do jua bëjë pyetjet Prokuroria. Mund të ketë pyetje dhe
23 Mbrojtësi i Viktimave. Dhe pasi të përfundojnë ata, mund t'ju
24 bëjnë pyetje Ekipet e Mbrojtjes. Por edhe Gjykatësit mund të
25 kenë pyetje për ju.

1 Prokuroria mendon se i nevojitet një orë e gjysmë për
2 t'ju bërë pyetjet. Mbrojtësi i Viktimave rreth 15 minuta.
3 Ekippet e Mbrojtjes kanë kërkuar shtatë orë e gjysmë. Inkurajoj
4 të gjitha palët të jenë sa më të kujdesshëm në shfrytëzimin e
5 kohës kur t'ju bëjnë pyetje. Trupi Gjykues mund të lejojë
6 pyetje plotësuese nëse përmbushen kushtet përkatëse.

7 Dëshmitar, përgjigju shkurt, qartë, nëse nuk e kuptoni
8 një pyetje, lirisht kërkon që pyetja të përsëritet ose
9 thjesht thoni që nuk e kuptoni që ta sqarojmë. Gjithashtu, na
10 thoni ku i bazoni ju faktet, rrethanat për të cilat do t'ju
11 bëjnë pyetje.

12 Në qoftë se Prokuroria ju kërkon të flisni për
13 korrigjimet që keni bërë në deklaratat e mëparshme, ju lutem
14 thoni me zë për procesverbal që deklaratat me shkrim, bashkë me
15 korrigjimet që ke bërë, pasqyron saktë dëshminë tuaj.

16 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara
17 se të përgjigjeni dhe flisni ngadalë dhe për përkthyesit.

18 Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit nuk
19 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
20 jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë se dikush jashtë kësaj
21 Gjykate të bën pyetje për dëshminë, na thuaj.

22 Në qoftë se unë them të mos flasësh më, të lutem
23 ndërprite fjalën dhe gjithashtu pusho nëse unë ngre dorën. Se
24 kjo do të thotë që unë do të jap një udhëzim.

25 Në çdo moment që keni nevojë për një pushim, na thuaj dhe

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 9

1 ne do të bëjnë organizimin përkatës.

2 Tani do të fillojmë me pyetjet e Prokurorisë, që janë në
3 të majtën tuaj. Dëgjojini me vëmendje.

4 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

6 Pyetje nga znj. Iodice:

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

8 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

9 PË. Mirëmëngjes.

10 PY. Unë quhem Vega Iodice dhe unë jam prokurorja që do t'ju
11 bëj pyetjet sot në emër të Prokurorisë. Siç ta shpjegova
12 takimin që patëm bashkë herën e fundit, në vend që t'ju bëjmë
13 pyetje për çdo gjë që ke informacion, ekziston mundësia që të
14 pranohen si provë gjyqësore disa deklarata që ke dhënë më
15 përpara. Por që ta bëjmë këtë duhet të ndjekim disa hapa.

16 Fillimisht flasim për identitetin tuaj. Si e keni emrin
17 dhe mbiemrin, Dëshmitar?

18 PË. Imer Imeri.

19 PY. Po datëlindja?

20 PË. 18 shkurt 1950.

21 PY. Cila është vendlindja juaj, ku keni lindur?

22 PË. Vojnik.

23 PY. Cili është shteti, çfarë kombësie keni?

24 PË. Shteti Kosova. Kombësinë shqiptar kosovar.

25 PY. Faleminderit. Dëshmitar, ju keni dhënë dhe deklarata dhe

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 10

1 më përpara dhe në gjykatat e Kosovës dhe gjatë seancës
2 përgatitore ne të dhamë mundësinë t'i lexoja dhe një herë këto
3 deklarata. Dhe ne duam që sot të pranohen si provë gjyqësore
4 deklaratat e tua.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për këtë i lutem Sekretarit të
6 seancës të vendosë në ekran materialin me ERN SITF00013369
7 deri në 13477 RED3, faqja 1 në anglisht dhe faqja 71 në shqip.
8 PY. Dëshmitar, a të kujtohet që ke dhënë deklaratë në hetimin
9 penal kundër Sabit Gecit në 2010?

10 PË. Po.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë në faqen 35 tek PDF-ja në
12 anglisht.

13 PY. Dëshmitar, nënshkrimi juaj është ky?

14 PË. Po.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani shohim materialin
16 SITF00016611 deri në 16701 RED3.

17 PY. Dëshmitar, a mban mend që ke dhënë dëshmi për dy ditë në
18 maj të 2011 në çështjen gjyqësore kundër Sabit Gecit, Riza
19 Alijas --

20 PË. Po.

21 PY. -- në Prishtinë?

22 PË. Po.

23 PY. Faleminderit.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani shohim materialin
25 SPOE00014585 deri në 14639 RED3.

1 PY. Dëshmitar, a të kujtohet që ke dhënë dëshmi në çështjen
2 kundër Xhemshit Krasniqit në 2016?

3 PË. Po.

4 PY. Faleminderit. A të kujtohet që javën e kaluar këto
5 deklarata i lexove në gjuhën shqipe?

6 PË. Po.

7 PY. A mban mend që t'u dha mundësia që të bëje disa
8 korrigjime dhe disa sqarime deklaratave të mëparshme?

9 PË. Po.

10 PY. A të kujtohet pastaj që këto korrigjimet i hodhëm në një
11 shënim të cilin më pas ta lexuam prapë ty?

12 PË. Po.

13 PY. A konfirmon që ato që të lexuam ne tek ai shënim
14 pasqyrojnë saktësisht korrigjimet që bëtë ju?

15 PË. Po.

16 PY. Tani, duke marrë parasysh korrigjimet dhe sqarimet që
17 bëre javën e kaluar, informacioni që përmbajnë deklaratat e
18 tuaja a është i vërtetë dhe i saktë me aq sa besoni dhe
19 mendoni ju?

20 PË. 100 për qind e vërtetë atë që e kam thënë.

21 PY. Nëse do të bënin të njëjtat pyetje sot për të njëjtat
22 ngjarje, përgjigjet e tua do të ishin të njëjtat?

23 PË. Sigurisht, të njëjtat.

24 PY. Faleminderit.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, meqë

1 përmbushëm kriteret e rregullës 154 dhe në përputhje me
2 vendimin F02489 paragrafi 49(c) dhe (d), kërkojmë që të
3 pranohen deklaratat e Speciales së Kosovës, përkatësisht me
4 numër SITF00013369 deri në 13403 RED3 dhe përkthimet në gjuhën
5 shqipe me numër SITF00013439 deri në 1377 RED3; procesverbali
6 i gjykimit të datës 4 maj 2011 me numër SITF0001611 deri në
7 16704 RED3, procesverbali i 5 majit me numër SITF00016493 deri
8 në 16533 RED3 dhe versioni në shqip me numër SITF00016534 deri
9 në 16575 RED3; procesverbali i gjykimit të 2016 SPOE00014585
10 deri në 14639 RED3; Shënimi Përgatitor 1, me numër 122484 deri
11 në 122489; dhe një provë materiale shoqëruese, SITF000431126
12 deri në SITF004311440, që është nga numri i dokumenteve me ERN
13 SITF431126 deri në 431161 RED.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Me përjashtim të kundërshtimeve që
16 kemi bërë ne në përgjigjen tonë për kërkesën sipas rregullës
17 154, nuk kemi kundërshtime të tjera.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të tjerët?

19 Nuk ka kundërshtime të tjera? Në rregull.

20 Materiali me numër SITF00013369 deri në 134303 RED
21 pranohet.

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Nëse e kam kuptuar
23 drejtë, kërkohet pranimi vetëm i faqeve SITF00013369 deri në
24 SITF00013403 për anglishten dhe për shqipen, apo jo?

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po.

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 13

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Dokumenti
2 merr numrin P01584 dhe klasifikimi është konfidencial.
3 Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
5 SITF00016611 deri në 16704, anglisht dhe shqip, RED3 pranohen.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin
7 P01585. Klasifikimi është konfidencial.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
9 SPOE00014585 -1439 RED3, anglishtja dhe shqipja, pranohen.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
11 numrin e provës P01586. Klasifikimi është konfidencial.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shënimi
13 Përgatitor me numër 122484 deri në 122489, po ashtu pranohet.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Më duket se ishte dhe
15 një deklaratë tjetër SPOE00014585 deri në 00014639 RED3?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Për provën P1586, ERN
18 është 00014693 edhe shqipja e ka numrin SPOE00014585 deri në
19 00014639 RED3. Nëse do t'i japim numër dhe kësaj, atëherë
20 numri përkatës do të jetë P01587.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 [Përkthim] Ky ishte numri që lexuat?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mbase bëra unë një gabim. Unë dua
24 që të pranohet edhe procesverbali i gjykimit të 2016,
25 SPOE00014585 deri në 14639.

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 14

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet. Por
2 çfarë numri do t'i japim?

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë ky dokument merr
4 numrin P01587.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po shënimin
6 përgatitor, a e lexuam siç duhet numrin? E kishim të saktë
7 numrin e Shënimit Përgatitor 12284 deri në 122489?

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi Përgatitor
9 122484 deri në 122489 merr numrin P01588.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet edhe
11 prova materiale shoqëruese.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti SITF00431126
13 deri në 00431161 RED, me faqen konkrete SITF000431126 deri në
14 SITF00431140, do të marrin numrin e provës P01589. Ju
15 faleminderit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, 1589.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Po e
18 them edhe një herë numrin. Numër është P01589.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit. Tani do të doja t'i
22 lexoja një përmbledhje të shkurtër të dëshmisë së dëshmitarit
23 për procesverbal.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshmitari 04735 është shqiptar i

1 Kosovës që është rrëmbyer në Kosovë nga ushtarët e UÇK-së me
2 maska sepse ishte përkrahës i LDK-së dhe e kanë mbajtur në
3 kazermën ushtarake të UÇK-së në Shqipëri ku e kanë rrahur
4 ushtarët e UÇK-së. Ai ka qenë në kushte të këqija sanitare
5 edhe ka parë se si janë keqtrajtuar personat e tjerë që kanë
6 qenë të ndaluar me të.

7 Rreth mesit të qershorit 1999, Dëshmitari 04735 u
8 transferua në Prizren ku u mbajt i ndaluar për disa ditë
9 bashkë me të tjerë, ku përfshiheshin serbë edhe romë, përpara
10 se ta lironin anëtarë të UÇK-së të cilët i kërkuan që të mos i
11 tregonte askujt se e kishin mbajtur të ndaluar.

12 PY. Z. Imeri, tani unë kam disa pyetje shtesë për ju.

13 PË. Urdhnoni.

14 PY. Pikësëpari dëshiroj që t'ju tregoj disa fotografi.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I lutem Sekretarit të Gjykatës që
16 të nxjerrë në ekran provën me numër ERN060639 deri në 060649.
17 Ju lutem kalojmë në faqen 3 të PDF-së, me numër ERN që
18 përfundon me 641. Ndërkohë dokumenti që është në ekran mund të
19 mos tregohet në ekran.

20 Ajo që unë kërkoj ka shtojcën RED.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
22 duket se versioni përkatës nuk ndodhet në listën e paraqitjes.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem a mund që ta zmadhoni
24 foton, pa tekstin në pjesën e sipërme të fotografisë?

25 Faleminderit.

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 16

1 PY. Zotëri, a e njihni këtë vend?

2 PË. Po, e njoh. Se në këtë vend isha i burgosur prej 12
3 prillit 1999 deri në më 20, 22 qershor 1999.

4 PY. Faleminderit. A mund të na thoni se ku ndodhet, pra, si
5 quhet ky vend?

6 PË. Ky vend quhet Cahan i Krumës.

7 PY. Dhe në cilën prej këtyre godinave këtu ju kanë mbajtur juve
8 të ndaluar?

9 PË. Këtu përpara si duket është një derë e vogël. E dyta
10 është dera e hymjes. Mbi derë të hymjes ish dritarja ku kam
11 nejt unë prej 12 prill deri më 20, 22 qershor.

12 PY. Një sekondë, ju lutem.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshiroj që t'i kërkoj
14 dëshmitarit që ta shënojë në fotografi.

15 PY. Dhe tani po e pyes vetëm për godinën. Nuk ka rëndësi.
16 Janë tre godina.

17 PË. Po.

18 PY. Ju lutem, në cilën, pra, vendosni numrin 1 sipër godinës
19 ku ju kanë mbajtur.

20 PË. Këtu.

21 PY. Mund ta shënoni dhe me një shigjetë. Të vendosni një
22 shigjetë dhe sipër shigjetës të shënoni numrin 1. Pra, numrin
23 1 ta shënoni sipër dritares.

24 PË. Aty isha unë. Në atë dhomë kam jetu prej 12 prillit deri
25 në 20, 22 qershor. Numër 1 është q'ajo.

1 PY. Faleminderit. Nëse ju kujtohet në këtë godinën e vogël
2 djathtas, që është në të djathtë të godinës dykatëshe, çka
3 kishte aty?

4 PË. Aty ishte kuzhina.

5 PY. Ju lutem vendosni numrin 2 afër asaj godinës 2 të cilët
6 ju e identifikuat si kuzhina.

7 PË. [Shënon]

8 PY. Faleminderit. Tani a e dini se çfarë ka qenë në godinën
9 në të majtë të godinës dy katëshe?

10 PË. Godina në të majtë është kanë -- ka pas material
11 luftarak, tesha të ushtrisë edhe ish kanë një dhomë me të
12 burgosur. Ishin katër oficerë të ish-Jugosllavisë që kishin
13 ardh në Shqipëri me iu bashkëngjite UÇK-së.

14 PY. Ju lutem, vendosni numrin 3 pranë asaj godine.

15 PË. [Shënon]

16 PY. Faleminderit. Në deklaratë tuaj, ju keni thënë se
17 tualetet ishin jashtë, është në provën materiale me numër
18 P1584, në faqen që mbaron me 13381. Në këtë fotografi a
19 mundeni me e gjet se ku ndodhej tualeti?

20 PË. Po.

21 PY. Ju lutem, shënoni numrin 4 aty ku sapo e shënuat se
22 ndodhej tualeti?

23 PË. [Shënon]

24 PY. Faleminderit.

25 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 18

1 këshillohen]

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ka edhe faqe të tjera të cilat do
3 të doja që t'i shikonim, por unë do të doja që të futeshin në
4 prova.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më duket se
6 dëshmitari ka diçka për të thënë. Çfarë keni për të thënë, z.
7 Dëshmitar?

8 DËSHMITARI: Po. I nderuar Gjykatës, Unë dua t'i drejtohem
9 popullit tim, që nuk jam këtu kundër UÇK-së. Se UÇK isha vetë
10 i shtati. UÇK-ja është e artë për popullin e Kosovës edhe
11 populli i Kosovës është i tërë UÇK.

12 Por, mjerisht, individë të caktuar veprat e tyre më kanë
13 sjellë sot këtu.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne dëshirojmë
15 që ju të keni mundësi të dëshmoni si të doni, por të presim
16 një herë çfarë pyetje ka Prokuroria sepse këto pyetje mund të
17 përputhen dhe me ato që thatë ju.

18 Por, nëse doni pastaj më vonë të thoni diçka, do t'ju
19 lejojmë që ta thoni.

20 DËSHMITARI: Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
22 Prokurore, mund të vazhdoni.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

24 Po, të nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin në provat
25 gjyqësore të kësaj fotografie, por mbase do të shënojmë dhe

1 fotografi të tjera, kështu që në fund fare mund t'i caktojme
2 një numër si një provë e vetme.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do të shikojmë dhe faqet e tjera
5 ku do t'i kërkoj dëshmitarit që të bëjë shënime dhe në fund
6 fare mund të kërkoj pranimin si një e vetme.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
8 kundërshtime?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk ka.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
11 kundërshtime. Në rregull.

12 ERN me numër 060639 deri në 060649 me numrin RED në faqen
13 3, siç tha Prokurorja, ka shënime?

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është faqja e tretë. Me numër ERN
15 060641.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 060641 është
17 faqja në veçanti e cila pranohet në provat gjyqësore.

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo merr numrin P01590,
19 aktualisht e klasifikuar si konfidenciale.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në fakt kjo mund të klasifikohet
21 si publike në qoftë se paraqitet vetëm kjo fotografi.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
23 Riklasifikohet si publike.

24 Znj. Prokurore, gjithashtu sa i takon temës së
25 klasifikimit, po katër deklaratat të cilat u pranuan në prova

1 gjyqësore?

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Duhet të qëndrojnë konfidenciale
3 për afekt të mbrojtjes së dëshmitarëve.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
5 Mund të vazhdoni.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

7 Ju lutem tani të kalojmë në faqen 5 të materialit PDF, që
8 kemi përpara në ekran. Ju lutem të bëjmë të njëjtën gjë të
9 zmadhojmë foton, për të përjashtuar që të mos duket teksti në
10 pjesën e sipërme. Ju lutem ta shohim të gjithë ndërtesën. Po.
11 Në rregull është. Faleminderit.

12 PY. Dëshmitar, a është kjo e njëjta godinë?

13 PË. Po, kjo është e njëjta godinë.

14 PY. Ju lutem qarkoni hyrjen kryesore në godinë dhe shënoheni
15 me numrin 1.

16 PË. [Shënon]

17 PY. Faleminderit. Ju lutem, shënoni me numrin 2 te dritarja e
18 dhomës ku ju kanë mbajtur juve.

19 PË. [Shënon]

20 PY. Faleminderit. Në të djathtë të hyrjes kryesore të godinës
21 është një derë, kush qëndronte aty?

22 PË. Aty qëndronin do vajza që kishin ardh prej Zvicre për të
23 mjeku të plaguarit.

24 PY. Faleminderit. Nga e dini që ishin do vajza aty?

25 PË. Po, në hyrje, në dalje, prej dhomës ku isha unë u dukshin

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 21

1 ato tuj hi e tuj dalë.

2 PY. A i keni ndigju të flisnin?

3 PË. Po.

4 PY. Çfarë thoshin?

5 PË. E kam ndëgjue një shumë e hidhnume e mërzitur. U kthy
6 prej frontit tuj i sha. "A jemi ardh me i mjeku vëllezërit a
7 me na dhunu llugave".

8 PY. Faleminderit. Me aq sa keni pa ju a ishin të lira ato të
9 lëvizshin?

10 PË. Po ato hijshin e dalshin q'aty, ma anej s'lijshin të
11 shkojshin.

12 PY. Faleminderit.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj që
14 të pranohet në provat gjyqësore kjo fotografi.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime
16 ka?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk ka.

18 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk ka.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është
20 faqja e pestë e të njëjtit material me numër ERN?

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Dhe përkatësisht është me
22 numër 060643.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 060643
24 pranohet.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë kjo i shtohet

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 22

1 materialit si provë gjyqësore me numër P01590, që është i
2 klasifikuar si publike tani.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem të nxjerrë në ekran
4 dokumentin me numër ERN 065573 deri në 065702.

5 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Nëse mund të sqaroj diçka?
6 Për provën gjyqësore është 1590 apo?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 1590 është.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem kalojmë në faqen e tretë
9 të PDF-së me numër 065575. Faleminderit.

10 PY. Z. Imeri, a i njihni këto godina?

11 PË. Po, po. E njëjta a.

12 PY. Në rregull.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem kalojmë tani në faqen 8
14 të këtij materiali PDF që mban numrin 065580. Ju lutem që të
15 duket fotografia në pjesën e poshtme të faqes, fotografia e
16 dytë. Faleminderit.

17 PY. Zotëri, a e njihni këtë dhomë?

18 PË. Po, atë natë që më kanë dërgu, më kanë shti në këtë
19 dhomë.

20 PY. E çfarë ndodhi në këtë dhomë?

21 PË. Në këtë dhomë mu ka përmend adhuruesi i presidentit
22 Rugova dhe hiqni dorë apo do vritni të gjithë edhe ka fillu
23 dajaku.

24 PY. Kush ju ka rreh në këtë dhomë?

25 PË. Sabiti mi ka dhënë dy shuplakë, më ka ra një herë me

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 23

1 patericë edhe tani me një dru të shkurtër. Komandant Hoxha,
2 Riza Alija, me emnin e vet, ai më ka fillu tu bien në krye e
3 gjithkund nëpër trup, kështu që jam kanë i mbulun me gjak.
4 PY. Ju lutem a mund të na e thoni emrin dhe mbiemrin, pra,
5 emrin e plotë të Sabitit?

6 PË. Sabit Geci.

7 PY. Faleminderit.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë tani në faqen
9 9 të PDF-së që mban numrin 065581. Të qëndrojmë në fotografinë
10 e sipërme. Pra, kjo fotografi që është, pa përfshirë
11 shpjegimin poshtë fotografisë. Shumë mirë kështu siç është.

12 PY. Dëshmitar, a e njihni këtë vend?

13 PË. Po. Kjo shkallëve përpjetë, në kry të shkallëve ishte
14 dhoma ku isha unë.

15 PY. Cila është dhoma ku ju mbanin juve? Ajo në të djathtë me
16 derën e hapur apo ajo dera tjetër ku është mu përballë?

17 PË. Jo, ajo dera, dera drejtë.

18 PY. Faleminderit.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë tani në faqen 10, që
20 është numër ERN 065582, të mbajmë pjesën e sipërme, pra,
21 fotografinë që është sipër.

22 PY. Dëshmitar, e njihni këtë dhomë?

23 PË. Po. Kjo është e njëjta me atë me atë kauçin e gjatë, ama
24 është tjetër kënd. Se Sabiti u tha atëherë ndez me kaftorin se
25 a ftoft.

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 24

1 PY. E keni fjalën për dhomën në katin përdhes, pra, në katin
2 e parë ku ju kanë rreh natën e parë?

3 PË. Po, po.

4 PY. Faleminderit.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
6 pranimin në prova gjyqësore të këtyre faqeve.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
8 kundërshtime?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka.

10 Z. TULLY: [Përkthim] Jo.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të katra
12 faqet? Apo vetëm kjo e fundit?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të katra, i nderuar Gjykatës. Dhe
14 nëse mundet të them, një faqe e kësaj prove është pranuar me
15 numër P85, që është faqja 065597. Kështu që mund t'i shtohet
16 asaj prove, të klasifikuar si publike.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për provën me
18 numër 065580 pranohet.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, të
20 katra faqet që kërkojnë të pranohen janë me numër 065575, 580,
21 581 dhe 582. Të katra do t'i shtohen provës materiale me numër
22 P85, e klasifikuar si publike. Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, janë
24 pesë fotografi të ndryshme. Janë pranuar të gjitha dhe u është
25 caktuar dhe numri i provës.

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 25

1 Mund të vazhdoni.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

3 I lutem Sekretarit tani që të na nxjerrë në ekran numrin
4 SITF00014681 deri në 14684. Në anglisht është në faqen 1
5 ndërsa në shqip është në faqet nga 2 deri në 4. Ju lutem në
6 versionin në shqip të kalojmë në faqen e tretë. Të zmadhojmë.
7 Po. Faleminderit. Po, mjafton. Shumë mirë është kështu.
8 Faleminderit.

9 PY. Z. Imeri, a mund t'i lexoni, a arrini t'i lexoni dot këto
10 emrat nga njëshi deri tek katra, 1, 2, 3, 4 apo doni që t'jua
11 lexoj unë?

12 PË. Nuk muj me i lexu.

13 PY. Në numrin 1, pra, nën 1 është emri Riza Alija me emrin e
14 babit Imer. Tek i dyti është Sali Rexhepi, atësia Miftar.
15 Numri 4 është Shaban Hoti, atësia Ahmet.

16 PË. Po.

17 PY. Ju kujtohet t'i keni takuar këta tre ushtarë të UÇK-së në
18 Cahan kur ju kanë mbajtur aty të ndaluar?

19 PË. Po, sigurisht. Se ai komandant Hoxha, Riza Alija ai ishte
20 kryesori i dajakut.

21 PY. Faleminderit.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj
23 pranimin në prova gjyqësore të kësaj liste ushtarësh.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
25 kundërshtime?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
3 Meqenëse nuk ka kundërshtime dokumentet 00014681 deri në
4 00014684, si në shqip dhe në anglisht, pranohen në prova
5 gjyqësore.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Marrin numrin e provës
7 materiale P01591. Aktualisht e klasifikuar si konfidenciale.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në fakt mund të klasifikohet si
9 publike.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të
11 riklasifikohet si publike.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

14 PY. Zotëri, kam edhe disa pyetje të tjera lidhur me Cahanin.
15 Ju lutem pa përmendur emra, pa cekur emrat e atyre që i kanë
16 mbajt të ndaluar bashkë me ju, kur t'i përgjigjeni pyetjeve,
17 kam këto pyetje.

18 Në deklaratën tuaj ju thatë se në një moment të caktuar
19 kishte deri në 17 të burgosur dhe disa prej tyre ishin anëtarë
20 të FARK-ut. Dhe ju keni përmendur dhe anëtarë të FARK-ut nga
21 Presheva.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kjo është në dokumentin me numër
23 P01584, faqet që mbarojnë në 382, 383.

24 PY. Krahas këtyre të ndaluarve, të burgosurve që ishin të
25 FARK-ut, a kishte edhe anëtarë të tjerë të FARK-ut në burgosur

1 në Cahan, pra, përveç këtyre të Preshevës?

2 PË. Po, isha unë ish in edhe ata që ish in me mu në burg aty.

3 Ne ish in anëtarë të Lidhjes Demokratike, kështu ish in të atij
4 krahu.

5 PY. Po, po tani dua që ta përqendrojmë vëmendjen tek personat
6 që ish in të burgosur me ju, po që ish in ushtarë ata. Dhe ju i
7 keni cek, keni cek atë nga Presheva. Po veç anëtarëve të FARK-
8 ut nga Presheva a kishte dhe anëtarë të tjerë të FARK-ut, të
9 burgosë aty bashe me ju?

10 PË. [REDAKTUAR]. Ishte dhe
11 një i Shipkovicës të Maqedonisë. Ish in edhe ata pesë a gjashtë
12 të Preshevës që kish in ardh mu kyç në ushtrinë FARK. Dhe i
13 kanë zënë dhe ata i kanë pru në burg aty te unë.

14 PY. A ju kujtohet një ushtar që ishte i plagos?

15 PË. Po, mirë më kujtohet ai. Dhe kam dhimbje sot për të.

16 PY. A mund t'u thoni Gjykatësve se kush ishte ai?

17 PË. Mjerisht emnin nuk ia di. Por ai ishte ushtar i FARK-ut
18 kish ardh pi Anglie me luftu. Një djalë 23 vjeçar. Edhe ka
19 dëgjue që familja e tij kanë ardh në Tiranë. Ka mendu të
20 shkojë t'i shoh familjen. Dhe ata që e kontrollonin në atë
21 kohë edhe FARK-un atje e kanë zënë tuj shku. Edhe ai s'ka
22 desht t'i dëgjojë edhe e kanë plague në shpatull me revole.
23 Edhe e kanë shti në kerr edhe ia kanë dorëzu Riza Alisë,
24 komandant Hoxhës.

25 Në 12.00 të natës apo në 2.00 të natës, s'jam i sigurtë,

1 e kanë prurë në dhomë tonë. Edhe ka thënë Riza Alija "Kush t'i
2 bën vend ktina do e rrafim fort". Edhe e la te këmbët. Nuk
3 mujta me duru aty edhe u çova e mora afër veti aty ku isha rat
4 unë.

5 Ai djali u mërzitke shumë, jam i plagum. Të nesrit e
6 refuzoi edhe bukën. Thashë "Jo, bacë, bukë duhet me hëngër,
7 thashë, se na kismet dalim pi këtujit". Kështu që kam kërku
8 një takim me Haki Drenicën, po tash nuk e di a a kanë Hakia a
9 Sali Berisha, i thashë "Çone more djalin te mjeki se më vjen
10 keq shumë. Ç'a kështu?".

11 E kanë marrë e kanë çu, ia kanë lidh varrën edhe dikush u
12 ka thënë që "Merrni me të mirë edhe djali mos të kallxon çka
13 ka ndodh". Ia kanë dhënë një farë detyre pak si të nalt aty me
14 nejt i lirë nëpër atë vend aty. Edhe u sillke asajte.

15 Nganjëherë folke me mu te dritarja apo kur dalsha me shku unë
16 në banjo. Edhe më falënderonte që i kam ndihmu. Kjo ka ndodh.
17 Ku e kanë çu mbasandaj, nuk e di.

18 PY. Dhe që të themi diçka për një sekondë, ju thatë që ata të
19 cilën e kanë plagu, ata që e kontrollonin dhe FARK-un, për të
20 cilin grup, organizatë apo ushtri, anëtarë të kujt ishin këta
21 që e kanë plagu atë?

22 PË. Ajo më vjen shumë keq me thënë tash, po në atë kohë, si
23 mbas fjalëve të djalit, ishin të UÇK-së që e kishin marrë nën
24 kontroll edhe FARK-un atje. Edhe ata e kanë nxënë edhe kanë
25 prurë aty, e kanë plagu dhe e kanë prurë aty.

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 29

1 PY. Në rregull. Faleminderit.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për pyetjet
3 e radhës do të doja të kalonim në seancë private për mbrojtjen
4 e dëshmitarit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të lutem të
6 kalojmë në seancë private.

7 [Mikrofoni çaktivizuar]. Dëshmitar, do bëjmë dhjetë
8 minuta pushim tani, pas dhjetë minutash do vish prapë në
9 sallën e gjyqit.

10 DËSHMITARI: Faleminderit. Anë, të nderum. Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
12 ju.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.
21 Faleminderit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Bëjmë dhjetë minuta pushim.

24 --- Seanca ndërpritet në orën 10.04

25 --- Seanca rifillon në orën 10.15

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 30

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
2 sillni dëshmitarin në sallë.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në seancë
5 private do të vazhdojmë?

6 Sekretar i seancës, na kaloni në seancë private.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 31

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.
4 Faleminderit.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

6 PY. Z. Imeri, dua t'ju pyes për kohën kur u transferuat në
7 Prizren. Në deklaratë ke thënë - deklaratata me numër P1584,
8 faqja që përfundon me numrin 13397, 98 - ke thënë që në fillim
9 ju çuan në një fjetore femrash dhe më pas në një garazh.

10 PË. Po.

11 PY. Dhe në këtë garazh të kanë çu me kerr. Kështu?

12 PË. Po.

13 PY. A mund të na tregosh çfarë rruge ndoqën ushtarët e UÇK-së
14 për të mbërritur tek garazhi?

15 PË. Aty ku ishim në atë vend të burgosur për dy ditë a tri,
16 erdhën ushtria gjermane dhe filluan me ju desh teshat e UÇK-së
17 dhe me jua marrë armatimin. Erdh dikush prej tyne poshtë dhe
18 na tha ne të dyve "Dilni se u lirut". Mendova, sigurisht po,
19 se kurrë se dijsa arsyen si muj të jem i burgosur.

20 Kemi dalë, tha "Hani çka të doni në kuzhinë". Drejtën me
21 të thënë s'mu hante kurrgjë. Edhe jemi dalë ndër hiqe, tha
22 "Dilni në hiqe". Më falni.

23 PY. Dëshmitar, disa nga këto hollësi i kemi në deklaratat e
24 tua. Unë dua të na tregosh vetëm ku ishte garazhi, domethënë,
25 dua të më përshkruash çka rruge ndoqën ata nga fjetorja deri te

1 garazhi, në qoftë se mundesh?

2 PË. Po. Ju i keni ato thatë të gjitha, znj. Prokurore.

3 Atëherë jemi hy në kerr, Xhemshiti ka gra kerrit ndërsa dy të
4 tjerët me revole në dorë dhe thonin "Mos luani". Na çuan në
5 drejtim të rrugës së Brezovicës.

6 Kur shkua në mes të qytetit, na kanë kthy në të djathtë,
7 në buzë të një mali. Ku filluan të na maltratojnë që në atë
8 mal do të bëhet dasëm apo do ju çojmë në furrë të qireqit në
9 Kleçkë. S'kam fol kurrëgjë. Na kanë çue në buzë të malit në një
10 shtëpi e rrethune me një mur të lartë edhe na kanë zdryp aty.

11 Xhemshit Krasniqi s'ka fol kurrë. Kur u zdryp pi kerri i
12 ka pështet duart në atë mure dhe ka marrë frymë thellë. I
13 mërzitur. S'ish sigurisht me vullnetin e tij. Edhe këta dy
14 tjerët na kanë marrë me revole në dorë na kanë shti në garazh.

15 PY. Që ta sqarojmë, ju thatë që po e voziste ai kerrin,
16 saktë?

17 PË. Po, po. Po, ai.

18 PY. Faleminderit. Kur thanë ata që do ju çonin në dasëm,
19 sipas jush ça deshën të thonin ata me këtë?

20 PË. Po na gjithmonë mendjen q'aty e kishim, që do të na
21 vrasin atje. Se atje dasëm s'kish në mal.

22 PY. Ti the që ju çuan në një shtëpi buzë një mali.

23 PË. Po.

24 PY. A mund të na e përshkruash pak si ishte kjo shtëpia?

25 PË. Po rruga që na çoi aty, na çoi deri në fund te buza e

1 malit te q'ajo shtëpi. Në të shmajt mbeti shtëpia. Ish e
2 rrethune me një mur të lartë. Hyrja e shtëpisë ish në fund të
3 murit në të shmajt. Tri-katër metra më anej ishte garazhda,
4 kur na kanë shpi në garazh.

5 PY. Faleminderit. Te garazhi si ju trajtuan ju?

6 PË. Po mjerisht. Gjithmonë me kërcënim të vdekjes, të
7 vrasjes. Por kur hymë në garazh pash një dritë cigare, se aty
8 ishte terr më, në fund. Edhe erdh kadalë dalë të pamit,
9 këqyri. Ishin shtatë veta. Ishin gjashtë serbë pleq 80, 90
10 vjeç edhe ish një magjup. Ku mjerisht, më vjen keq me dëgju
11 populli jem thotë po ju mban krahun serbëve, jo, nuk është
12 ajo, se unë e kam qejf e lus, Gjykatësit i lus që në fund të
13 tregojë kush jam edhe ligjin tonë kombëtar ushtarak e
14 njerëzor.

15 Edhe këqyra ishin ata. U ulëm unë [REDAKTUAR]
16 prej menç, rrëshkiti. "Du me thy murin" thojke. Muri është
17 beton s'u thejke. Thashë "Ka dale se Zoti na ka pështu deri
18 këtu dhe do të na pshtojë. Kështu që kemi nejt dy ditë aty. Na
19 kanë maltratue. Çka kishin krejt në dorë të tyne fjalë
20 ofenduese, me na rraf jo. Aty jo. Ata tjerët i rrehshin, neve
21 jo.

22 Kështu që ditën e tretë i kem ni duke i thënë "Deshi
23 teshat e UÇK-së se na kanë hetue KFOR-i". Edhe ma ka marr
24 mendja që na lirojnë.

25 PY. Dua të sqaroj një detaj të vogël këtu, se pjesën më të

1 madhe e kemi nga deklaratat e mëparshme. The që:

2 "Rrahën të tjerët po nuk na rrahën ne."

3 Kush ishin këta të tjerët që rrahën ata?

4 PË. Po ishin do djem të rinj aty që i rrahën ata, por unë
5 emrat s'ia u disha atyne. Ata nuk i njoh askënd.

6 PY. Domethënë, u rrahën, këta rrahën këta të moshuarin serbë
7 dhe këtë magjypin?

8 PË. Po.

9 PY. Këta çunat e rinj që i rrahën ata të cilës organizatë
10 ishin, të cilës ushtri?

11 PË. Ata u mbajshin si UÇK, por ishin djem të dirigjum pi
12 dikuj. Nuk ish që ata si ushtri vepronin, por si të dirigjum
13 pej dikuj.

14 PY. Pse mendon ti që kanë qenë të dirigjum prej dikujt, ku e
15 bazon këtë?

16 PË. Po unë e besoj që edhe Sabit Geci u kanë i dirigjum pej
17 dikuj që të më thotë mue je adhurues i LDK-së edhe do u vrasim
18 të gjithëve. Edhe Riza Alija në q'atë mënyrë ka veprue. Na
19 kanë keqtrajtue si njerëz të LDK-së. Siç dihet kjo, vrasje të
20 shumta ma vonë.

21 PY. Këta djemtë që ishin në garazh dhe që po rrihnin këta të
22 moshuarit, çfarë teshash kishin?

23 PË. Po kishin tesha të verdha, të gjelbërta. Por ata kanë
24 mujt me vesh çka dojn.

25 PY. Faleminderit. Dëshmitar, kam dhe dy pyetje të fundit.

1 Fillimisht arrestimi dhe ky ndalimi, burgimi, çfarë ndikimi
2 pati tek ty?

3 PË. Si?

4 PY. Po. Çfarë pasojash pati ky arrestimi dhe ky ndalimi tek
5 ty çfarë pasojash të la, çfarë ndikimi pati?

6 PË. Ky pat pasoja vdekjeprurëse. Me rrafjet që i përjetova,
7 me thymjen e nofkës, me vorr në krye, me gjak një muaj ditë pa
8 mu hjek gjaku pej kryje, pi trupi edhe me maltratime të një
9 mbas njëshme. Këto ishin vetëm për akuzën që ma tha Sabi Geci.
10 Edhe kjo u vërtetue edhe deri më sot.

11 PY. Po sa i takon faktit që ju keni fol hapur lidhur me atë
12 çka u ka ndodh, ky fakt çfarë pasojash ka pas për ju për jetën
13 tuaj?

14 PË. Po mu më burgosën, më rrafën si një njeri i një familje
15 të mirë kombëtare. Ma vranë vëllaun. Edhe ma hoqën frikën se
16 për të se vdekja s'kishte ça më ban, kështu që jam dalë hapur
17 me i tregue edhe jam shumë i mirëpritun në popullin tim
18 dëshmia ime. Se kurrë nuk kam rrejt, s'do të rrej as sot as
19 kurrë një herë.

20 PY. Faleminderit.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje të tjera.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pala tjetër.

23 Pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave:

24 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim]

25 PY. Mirëdita, z. Imeri.

1 PË. Mirëdita.

2 PY. Më quajnë Maria Radziejowska, jam Mbrojtëse e Viktimave
3 në këtë çështje gjyqësore.

4 PË. Faleminderit.

5 PY. Sot dhe në deklaratat e mëparshme, ju keni përshkruar me
6 hollësi burgimin tuaj dhe rrahjet që jua kanë bërë gjatë atij
7 burgimi, dua t'ju bëj edhe disa pyetje të tjera lidhur me
8 ndikimin, pra, pasojat që kanë pasur ky burgim dhe këto rrahje
9 për ju dhe për jetën tuaj. Në rregull.

10 PË. Në rregull. Faleminderit.

11 PY. Cekët para pak lëndimin fizik që ju është shkaktuar nga
12 rrahjet dhe këto dhe në hollësi i keni përmendur në deklaratë.

13 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Dhe, për procesverbal, kjo
14 është me numër P1584, SITF0003377 dhe 8 dhe një shembull
15 tjetër. P1585 me numrin SITF00016628 dhe 29 dhe një faqe
16 tjetër është 16634.

17 PY. Ju në këtë deklaratë keni përmendur lëndimet në kokë, pra,
18 varren në kokë, lëndime në krahë, e të tjera. Sa kohë ju është
19 dashur që t'ju shërohen këto plagë?

20 PË. E nderuara, as sot nuk janë të shërume si duhet, por Zoti
21 i madh ma ka fal jetën e ma ka mundësi që të vij para
22 drejtësisë këtu. Ankesa kam gjithnjë.

23 PY. Ju lutem më me hollësi me ia shpjegu Gjykatësve vuajtjet
24 dhe dhimbjet që juve ende i keni sot?

25 PË. I kam të dukshme këtu edhe në krye. Kam dhimbje në dorë.

1 Krahun nuk muj e lëviz. Tre kilogram s'muj i çoj me këtë dorë.
2 Edhe mjeki e ka konstatue që ndoshta një ditë do të përfundon
3 që mos me lëviz ma. Kam dhimbje në shpinë pej rrafjeve të
4 mëdhaja ku tre herë jam rraf që jam ka i livanosun, jam kanë
5 pa vetëdije, që s'ma ka marrë mendja që shpëtoj gjallë. A ata
6 ndërkohë ka shkojsha në banjo, ku ua sqarova sa larg ishte
7 derisa shkelma edhe nga një stups edhe gjithnjë me duar lidh
8 kam hëngër bukë. Me durë lidh kam shku në bagjo. Me durë lidh
9 kam fjet. Paramendoni tash çfarë vështirësish janë kanë këto
10 të gjitha. Po gjithmonë ymydin [Fonetikisht] te Zoti që Zoti
11 një ditë do të m'qet para drejtësisë edhe ajo ditë erdh sot.
12 Ju falënderoj Trupin Gjykues dhe të gjithë të tjerëve.

13 PY. A keni edhe sot e kësaj dite dhimbje koke?

14 PË. Kam dhimbje koke sigurisht. Nganjëherë e hupi vetëdijen.
15 Nganjëherë harroj shumë. Edhe me gjumë nuk jam kurrqysh. Gjumë
16 kam pak. Më del gjumi natën. Kujtesa, por këto shqetësime nuk
17 janë badihava. Dihet ajo krejt ça më ka ndodh mue.

18 PY. Barna a merrni me e pakësu pak dhimbjen?

19 PË. Edhe një herë?

20 PË. A merrni ilaçe, a pini ilaçe me qetësu dhimbjen?

21 PË. Marr ilaçe, marr. Marr ilaçe. I marr 12 tableta në ditë.

22 PY. Tani dua t'ju pyes për pasojat që patën rrahjet dhe
23 burgosja në vitin 1999 dhe sa i takon anës psikologjike për
24 ju.

25 Gjatë kohës që ju kanë mbajt të burgos, ka pasur shumë

1 raste shumë situata kur keni kujtu se mundet që të mos
2 mbeteshit gjallë, mos dilnit gjallë prej asaj përvoje. E cekët
3 dhe sot.

4 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Por edhe në provën
5 materiale me P1584 me numër SITF00013378 apo P1584 me numër
6 SITF00016632.

7 PY. Sa shpesh, me aq sa mbani mend, sa shpesh gjatë kohës që
8 keni qenë i burgos e keni mendu që edhe mund të mos dilshit
9 gjallë prej asaj burgosjeje?

10 PË. Ndoshta jo për natë, veç çdo e dyta natë po. Mu ka rraf
11 dera "Bënu i gatshëm se tash po vritesh". Tash paramendoje
12 ndjenjat e njerit. Dikur u mësova edhe me atë. S'kisha ku të
13 shkoj isha aty. U rrejke dera thojke "Bënu i gatshëm se tash
14 po vritesh". Sabit Geci më tha "Krejt LDK-në kena me ju vra".
15 Ku e vërtetojë atë. Pej atëherit dhe mbas luftës shumë më.
16 Edhe unë e pritsha ashtu qysh tha ai.

17 PY. Sot që flasim si ndiheni lidhur me këtë çka ka ndodh,
18 domethënë, me këtë ide të vdekjes që të qëndron kështu mbi
19 kokë me këto rrahje, si ndikon kjo, çka pasojash ka për ju sot
20 flas nga ana psikologjike?

21 PË. Po nga ana psikologjike kjo ka shumë, se njeri me e pa
22 vdekjen në çdo orë, në çdo ditë, me ju sjell vdekja ka kry
23 shumë e rëndë. Por edhe ajo që më ka shty të jem i hapur është
24 kjo që të shohin të gjithë vuajtjen time se diçka gati si e
25 pamundshme. Qysh me ndodh kjo e një familje në Drenicë, jemi

1 një vend ma patriotik në Kosovë edhe në shqiptari. Jemi
2 familja më kombëtare, më patriotike. Mujn këtë me e tregu edhe
3 këta zotërinjtë që janë këtu. E dinë të gjithë.

4 Po pse më ndodhi mue? Mjerisht, për këta e keqja LDK-ja,
5 presidenti Rugova. Edhe këqyrshin me na likujdu të gjithëve.
6 Më vjen keq shumë.

7 PY. A mendoni se emri i mirë i yti apo i familjes tuaj është
8 njollos është prish si të thuash për shkak të kësaj burgosjeje
9 dhe keqtrajtimi që ka ndodh në 1999?

10 PË. Po emni i mirë i jemi me siguri isha shok i Isuf
11 Gërvallës, një heroi kombëtar, pej 17 janar 19981, që e kanë
12 vra UDB-ja serbe. E jemi kanë për Kosovën Republikë. Qysh pej
13 atëherit kam fillu luftën unë. Edhe isha shok i Adem Jasharit
14 që Rifati është gjallë, fatbardhësisht, a mirë në memorie, ai
15 mund i vërteton këtu. Unë isha shoku i Adem Jasharit e jo këta
16 këtu dhe ata tjerët atje.

17 Edhe plus asaj familja, katragjyshi në luftë me turkun,
18 babëgjyshi në luftë me Serbi, baba jem luftëtar i
19 nacionalistit më të madh shqiptar Shaban Polluzha, vëllavi jem
20 me dy fakultete, krah i djathtë i presidentit Rugova. Kështu
21 që po të tregojnë vetë faktet. Këto janë krejt realitet. Kjo a
22 e vërteta.

23 PY. Mendoni se do të jeni ndonjëherë në gjendje me e harru
24 dhimbjen e të gjithë të tjerave, keqtrajttimeve që ua kanë
25 shkaktu gjatë burgosjes në 1999?

1 PË. Është vështirë me i harru. Sikur mos mu kish vra vëllau,
2 ndoshta isha përpjek me harru. Por këta e vunë kulmin e të
3 gjithë të këqijave që ma vranë vëllaun, një djalë i një
4 familjeje kombëtare, një djalë i shkollum, kur u bë me i vu
5 shtetit e vetja e tëna mu çu me e vra me ia marrë jetën. Edhe
6 me thënë s'di kush e vrau. Këta të katër janë të
7 institucioneve të Kosovës ku kanë shërbu me u vra të gjithë
8 ata njerëz dhe mos me u ditë kurrë kush i vrau. Heshtje.
9 Gjithmonë heshtje. Ajo më ka shty të jem i hapur këtu para
10 drejtësie e ti shiqoj në sy. Jam shumë i kënaqur me juve, të
11 nderuar. Zoti qoftë i kënaqur me juve si unë.

12 Z. TULLY: [Përkthim] Z. Kryetar. Z. Kryetar. Z. Kryetar.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

14 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim]

15 PY. Ju lutem, më dëgjoni me vëmendje, ju lutem. Kam nja dy
16 pyetje tani që duhet t'u përgjigjeni vetëm me po ose me jo. E
17 kuptoni? Pra, të thoni vetëm po ose jo.

18 PË. Po.

19 PY. Pra, mjafton një po ose një jo si përgjigje në pyetjet e
20 mia. Zotëri, jeni takuar ndonjëherë me Hashim Thaçin, po a jo?

21 PË. Po.

22 PY. Gjatë këtij takimi a e keni pyet Hashim Thaçit pse ju
23 kanë burgos dhe keqtrajtu?

24 PË. Po.

25 PY. Ai a jua ka dhënë ndonjë shpjegim pse jeni burgos dhe

1 keqtrajtu?

2 PË. Ai më ka thënë se nuk e ka dit.

3 PY. A ju ka kërku ndjesë për këtë burgosje dhe keqtrajtim?

4 PË. Po ai ka thënë "Më vjen keq".

5 PY. A ju kujtohet se kur ka ndodh ky takim, afërsisht? Dhe
6 sigurisht këtu s'përgjigjeni dot me po ose me jo, sigurisht
7 datën?

8 PË. Po, më kujtohet. Kjo ishte në fund të vitit 2016, në
9 fillim 2017.

10 PY. Dhe veç këtij takimi pas lufte, ndokush prej UÇK-së a ju
11 ka kontaktu me hetu këtë rastin e burgosjes dhe keqtrajtimit
12 tuaj?

13 PË. Askush. I vetmi Hashim Thaçi ka kërku në media që të
14 zbulohen këto raste vrasjet e LDK-së. Edhe e ka thirr
15 Prokurorin e Përgjithshëm në atë kohë pa ju deklaruar --

16 PY. Më falni, zotëri. Zotëri, ju kërkoj ndjesë. Po ju pyesja
17 vetëm për ndalimin, pra, burgosjen dhe keqtrajtimin në vitin
18 1999, vetëm për këtë e kisha fjalën.

19 PË. S'e kuptova. Pak ma në zë me fol dikush mu bë mirë a.

20 PY. Po patjetër. Po ju pyes vetëm për ndalimin dhe
21 keqtrajtimin tuaj në 1999. Dhe pyetja ime është kjo: Dikush
22 nga UÇK-ja a ju ka kontaktu me hetu këtë çka ju ka ndodh, pra,
23 burgosjen dhe keqtrajtimin tuaj në 1999?

24 PË. Askush.

25 PY. Faleminderit, zotëri.

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 47

- 1 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.
- 2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
- 3 znj. Radziejowska.
- 4 Pala tjetër?
- 5 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të filloj tani?
- 6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
- 7 Z. MISETIC: [Përkthim] Patjetër.
- 8 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:
- 9 Z. MISETIC: [Përkthim]
- 10 PY. Mirëmengjes, z. Dëshmitar. Më quajnë Luka Misetic. Jam
- 11 avokat mbrojtës i z. Thaçi dhe kam disa pyetje për ju.
- 12 PË. Urdhnoni.
- 13 PY. Faleminderit. Dëshmitar, pyetja e parë që kam është kjo:
- 14 Gjithmonë është ditur shumë mirë edhe në vitin 1998 se ju dhe
- 15 familja juaj keni qenë mbështetës të z. Rugova dhe të LDK-së,
- 16 a është kështu?
- 17 PË. Po.
- 18 PY. Dhe ju dhe vëllai juaj, pra, të dy ju në vitin 1998 jeni
- 19 kyç në UÇK, kështu është?
- 20 PË. Po.
- 21 PY. Në fakt, ju njiheni si veteran i UÇK-së edhe sot, e keni
- 22 statusin e veteranit, kështu?
- 23 PË. Po.
- 24 PY. Djemtë tuaj janë kyç në UÇK, kështu?
- 25 PË. Sigurisht.

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 48

1 PY. Dhe në një prej deklaratave tuaja me numër P1585, ju keni
2 thënë se ka pas edhe një punkt kontrolli të UÇK-së pranë
3 shtëpisë tuaj në vitin 1998, pra, deri në dhjetor të vitit
4 1998?

5 PË. Po.

6 PY. Gjatë kohës që ju keni qenë i kyç në UÇK gjatë vitit
7 1998, askush brenda UÇK-së në vitin 1998, pra, gjatë kohës që
8 ju dhe anëtarë tjerë të familjes tuaj keni qenë anëtarë të
9 UÇK-së --

10 PË. Po.

11 PY. -- pra, askush nuk ju ka kërcënu, kështu?

12 PË. Nuk na ka kërcënu drejtpërdrejtë por jemi ka pak si të
13 kritikum si anëtarë të LDK-së.

14 PY. Po kush ju ka kritiku?

15 PË. Po dikush aty rrethi. U niyshin fjalë prej njerëzve. Tash
16 unë me emër nuk muj me i fol, por është shumë e vërtetë.

17 PY. Megjithatë, ju është leju që të kyçeni në UÇK e të
18 merrshit pjesë në UÇK, kështu është?

19 PË. O i nderuar, UÇK ishte krejt populli. Të gjithë ishim
20 UÇK.

21 PY. Pastaj e keni lëshu Kosovën në dhjetor të 1998, kështu
22 është?

23 PË. Po.

24 PY. Keni shku në Kroaci, kështu është?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 49

1 PY. Dhe pas katër muajsh në Kroaci jeni kthyer në Shqipëri me
2 kërku familjen, kështu?

3 PË. Jo, katër muaj. Në Kroaci kam shkue në fund të dhjetorit
4 edhe jam kthyer kur ka filluar NATO-ja me bombardime në Kosovë,
5 domethënë, dy muaj, dy muaj e gjysë.

6 PY. Në një deklaratë, në një prej deklaratave tuaja me numër
7 P01584 keni thënë se keni shkuar në Shqipëri në fund të prillit,
8 kështu?

9 PË. Jo, jo, jo. Jo, nuk është ashtu hiç. Dikush aty -- kjo a
10 manipulim.

11 PY. Jo, jo nuk e kam për manipulim. E kam për -- po citoj
12 deklaratën e dëshmitarit.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Që është këtu në prova dëshmia me
14 numër P1584 në faqen SITF00013375.

15 PY. Këtu keni thënë:

16 "Po, kam shkuar në Shqipëri më datë 8 prill, kam filluar me
17 kërku familjen në Durrës pastaj në Tiranë."

18 Nuk është e saktë kjo?

19 PË. Unë prej Kroacisë jam ardhur në Shqipëri në datën 10 prill,
20 8 apo 10 prill. Është realitet. Edhe kam filluar me të kërku
21 familjen në Tiranë, në Kukës, ku dhe në Cahan në Krumë më
22 ndodhi më e keqja.

23 PY. Po. Dëshmitar, tani është momenti i pauzës, kështu që nuk
24 po bëj më pyetje tani që të bëjmë pauzën.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dëshmitar,

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 50

1 do të bëjmë pushimin prej gjysmë ore. Mos harroni, nuk duhet
2 të flisni me askënd jashtë sallës së gjyqit për dëshminë që
3 keni dhënë këtu. Nëse dikush ju bën pyetje për dëshminë që
4 keni dhënë këtu, na e thoni.

5 Znj. Asistente e sallës, mund të shoqëroni dëshmitarin të
6 dalë nga salla.

7 DËSHMITARI: Ju faleminderit.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë
10 ndërprerjen e seancës këtu deri në orën 11.30 minuta.

11 --- Pauza fillon në orën 11.02

12 --- Seanca rifillon në orën 11.30

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
14 sillni dëshmitarin në sallë.

15 Përpara se të fillojmë, prova që i dhamë numrin provizor
16 1592, ne në fakt e pranojmë kundërshtimin, sa i takon
17 autenticitetit. Nuk kemi informacion të mjaftueshëm, më falni,
18 as për prejardhjen e dokumentin dhe as për periudhën përkatëse
19 kohore të këtij dokumenti.

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
22 Dëshmitar. Tani z. Misetic do vazhdojë me pyetjet e veta.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

24 PY. Përshëndetje përsëri, Dëshmitar. Unë do vazhdoj aty ku e
25 lamë gjatë pushimit. Pra, ti ke shkuar në Shqipëri në prill të

1 1999-s. Dhe atje të ka ndaluar Sabit Geci, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Ti ke thënë në deklaratën e 2011 se gjatë kohës që të
4 kanë mbajtur, gjatë kohën që të kanë mbajtur të ndaluar, Sabit
5 Gecit i ke përmendur emrin e Hashim Thaçit. Ia ke thënë këtë
6 hetuesve në 2011?

7 PË. Po.

8 PY. Kur të intervistoi Prokuroria këtu, kjo është në
9 dokumentin me numër 083218-TR-ET, Pjesa 1, faqja 32, rreshtat
10 9 deri në 23, ti Prokurorisë këtu i ke thënë se nuk e dije a
11 kishte ndonjë autoritet z. Thaçi për të të liruar, kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Prokurorisë i ke thënë se e përmende emrin e z. Thaçi se
14 mendove se mbase do të ndihmonte kjo gjë sepse familja e tij
15 njihte familjen tënde, se jetonin afër, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Në deklaratën e majit 2011, ke thënë se kur ia përmende
18 emrin e z. Thaçi z. Geci, ai kinse të paska thënë ty që z.
19 Thaçi e di që të kanë arrestuar ty, kështu?

20 PË. Ka thanë, "E din z. Thaçi", e kam përmend edhe Shtabin e
21 Përgjithshëm, ka thanë, "Të tanë e dinë se ti je këtu".

22 PY. Po. Ai nuk të tha ty nga e dinte z. Thaçi këtë?

23 PË. Jo, ai nuk dhanke informata shumë. Ai veç e dirigjonte
24 dajakun.

25 PY. Po, ama nuk të tha ndonjë, nuk të tregoi ndonjë provë ai

1 ty që vërtet z. Thaçi e dinte që ishte arrestuar ti?

2 PË. Jo, jo. Ai nuk foli ma.

3 PY. A mban mend që para se t'i jepte deklaratën EULEX-it më 9
4 qershor 2010, ke dhënë dhe katër deklarata të tjera për
5 arrestimin tënd? Më duhet t'i jap detajet për palët. I keni
6 dhënë deklaratë policisë së UNMIK-ut më 8 shkurt 2001, me
7 numër SITF00016576 deri në 00016576 RED. Të kujtohet që më 8
8 shkurt 2001 i ke dhënë deklaratë policisë së UNMIK-ut?

9 PË. Po në qoftë se është shkruar aty, sigurisht e kam dhanë.

10 PY. Kemi dhe një memo, një shënim, që e ka përgatitur një
11 hetues. Aty flitet për një intervistë që ka pasur me ty më
12 datën 6 tetor 2009. Numri i dokumentit është SITF00373933 deri
13 në 00373933 RED2. Të kujtohet një intervistë që ia ke dhënë
14 hetuesve të EULEX-it më 6 tetor të 2009?

15 PË. Unë kam dhanë shumë intervista. Por, pa m'i përmend nuk e
16 di tash çka.

17 PY. Mirë, unë po të them që kemi atë që të thashë më përpara,
18 kemi këtë që i keni dhënë EULEX-it më 6, 2009. Dhe kemi dhe
19 procesverbalin ku ke dhënë dëshmi në datën 24 shkurt 2010, në
20 një gjykim. Tani, unë dua të të pyes këtë, a është e vërtetë
21 në asnjë prej deklaratave që ke dhënë më përpara, ti nuk ke
22 thënë që Sabit Geci të ka thënë ty se Hashim Thaçi e dinte që
23 ti ishte arrestuar?

24 PË. Këto janë 25 vite. Prej gjithë asaj ça më ka ndodh mue,
25 edhe 25 vite vonesë, ka ndodh ndonjë, ndoshta që kam harru

1 apo, por çka e di unë, kam fol gjithnji të vërtetën.

2 PY. Po. E pranoj këtë. Unë thjesht po ju pyes, a e pranoni që
3 hera e parë që e ke përmendur këtë detaj ka qenë data 5 shkurt
4 2010, më fal, në qershor të 2010, për herë të parë e ke thënë
5 në deklaratën e pestë që ka qenë qershor i 2010? A e pranoni
6 këtë?

7 PË. Po, që e keni të shkruara, ndoshta është ashtu, s'po di.

8 PY. Në rregull. Të flasim për një aspekt tjetër. Kjo lidhet
9 me diçka që i ke thënë javën e kaluar ZPS-së, Prokurorisë
10 këtu, kur u takuat për të sqaruar disa pjesë të deklaratave të
11 mëparshme.

12 Do të lexoj një paragraf, është paragraf i gjatë. Unë do
13 flas ngadalë. Por, kjo është zbardhur këtu, kjo është
14 dokumentuar që ia ke thënë Prokurorisë javën e kaluar, dhe
15 unë dua të na e konfirmosh nëse vërtet ia ke thënë Prokurorisë
16 këtë gjë.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Është paragrafi 39, Shënimi
18 Përgatitor 2, me faqe 122480. Mund ta vendosim në ekran. Po i
19 jap numrin e referencës Sekretarit të seancës, 1222473 [Sipas
20 përkthimit] deri në 122483, faqja 122480.

21 PY. Këtu thuhet kështu:

22 "...Dëshmitari 04735", që jeni ju, Dëshmitar, "shpjegoi
23 se ka pasur kontakte me Abedin Rexhën përpara se të vritej.
24 Rexha i kishte kërkuar Dëshmitarit 04735 t'i dorëzonte armën.
25 Ka filluar kur Hakia, vëllai i Dëshmitarit 04735, u plagos

1 rëndë më 6 gusht 1998. Gjatë kohës që po çonte Hakinë në
2 spital, Hacia dhe Dëshmitari 04735 u ndaluan nga policia
3 serbe, të cilët u drejtuan armët dhe u thirrën, "terroristë".
4 Dëshmitarin 04735 e rrahu policia serbe, por sidoqoftë, Hakinë
5 e çuan në spital dhe atje pati, i bënë një operacion. Pas
6 gjashtë javësh, Dëshmitari 04735 e çoi vëllaun në shtëpi.
7 Atje, një motër, Liri Loshi, kishte raportuar stacionin, një
8 stacion radioje Shqipëria, se Haki Imeri ishte lënduar nga
9 forcat serbe, ishte plagosur nga forcat serbe. Dëshmitari
10 04735 u zemërua me motrën, dhe nuk e kuptonte pse e tha këtë,
11 se kjo gjë mund ta vriste vëllain e tij. Motra, infermierja
12 pra, i raportoi Shtabit të UÇK-së se ishte kërcënuar nga
13 Dëshmitari 04735. Në mbrëmje ushtarët e UÇK-së shkuan në
14 shtëpinë e Dëshmitarit 04735, dhe Abedin Rexha i kërkoi
15 Dëshmitarit 04735, dhe babait të tij, të shkonin në Shtabin e
16 UÇK-së. Kur shkuan në shtab, mbërriti Abedini dhe e pyeti
17 Dëshmitarin 04735 nëse e kishte kanosur infermieren.
18 Dëshmitari tha që jo. Abedini i tha Dëshmitarit 04735 se nëse
19 ndonjë prej shtatë vëllezërve Geci do të shkonte në familjen e
20 tij dhe tha, 'nëse unë të shoh që takohesh me ta, do ta dëmtoj
21 shtëpinë me raketë'. Ai i kërkoi Dëshmitarit 04735 të
22 dorëzonte kallashnikovin e tij. Dëshmitari 04735 nuk pranoi,
23 dhe Abedini e kërcënoi me revolver. Abedini i dha një detyrë
24 ushtarake që të shkonte te shtatë vëllezërit, do të thoshte që
25 do t'i vriste të gjithë. Dëshmitari 04735 pranoi dhe të

1 nesërmen shkoi tek shtatë vëllezërit, u tha të ishin të
2 kujdesshëm dhe u përcolli mesazhin nga Abedini dhe Flladi nga
3 Gjilani, se do t'i vrisnin. Abedini vdiq pak kohë më pas.
4 Askush nuk e kërcënoi Dëshmitarin 04735 gjatë kohës që Abedin
5 Rexha vdiq dhe deri në momentin që shkoi në Kroaci. Sabedin
6 Geca -- Sabedin, Sabit Geci - më falni - asnjëherë nuk e
7 fajësoi Dëshmitarin 04735 për vdekjen e Abedinit. Dëshmitari
8 04735 dhe Abedini asnjëherë s'kishin pasur probleme me njëri-
9 tjetrin."

10 Dëshmitar, ia keni thënë këtë Prokurorisë javën e kaluar?

11 PË. Ia kam thanë Prokurorisë javën e kaluar që kurrë njëherë
12 kush përmend nuk ma ka, se u ka e, pse ma përmend, s'kam të
13 baj aty. Kjo që po ngritët këtu, është ne vëllagrindje mes
14 vete, e cila nuk është mirë, nuk çon peshë kjo punë. Pse kurrë
15 njëherë s'kam pas të keqe me Abedin Rexhën.

16 Puna politike, ata kanë kërkuë që krejt njerëzit e LDK-së
17 t'i dorëzojnë armatë, armët, ama nuk u kanë patjetër me jua
18 dhanë. Kjo është absurde, kush përmend s'ma ka kurrënjëherë,
19 kurrë. Kjo është e vërteta.

20 PY. Ju lutem, vetëm fokusohu tek pyetja ime. Ajo që lexova
21 unë, a pasqyron saktë atë që i ke thënë javën e kaluar
22 Prokurorisë?

23 PË. Po në rregull është ajo që i thatë ju, dhe në rregull ajo
24 që i kam thanë Prokurorisë, sigurisht, qëndroj që i kam thanë
25 Prokurorisë. Ama unë nuk i kam thanë Prokurorisë që më ka

1 thanë dikush diçka për vrasjen e Abedinit ku nuk qëndron
2 absolut kurrëgjë. Ne jemi kushërinj të parë, katragjyshat
3 vëllezër. Mundet edhe në familje brenda në shtëpi me pas
4 ndonjë pamarrëveshje, ama të keqe me veti s'kemi pas kurrë.
5 Kjo është realiteti. Mundesh me pyet edhe sot e 100 vjet.

6 PY. Abedin Rexha, siç the vetë është kushëri i juaji --

7 PË. Po.

8 PY. -- dhe po ashtu është kunati i Sabit Gecit, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Tani, sa i takon periudhës kohore të kësaj, po të them
11 unë ty që Abedin Rexha është vrarë rreth datës 8 tetor 1998,
12 pajtohesh me mua apo e konteston këtë?

13 PË. Si?

14 PY. Abedin Rexha është vrarë rreth datës 8 tetor 1998, e
15 pranon këtë?

16 PË. Ashtu që është ajo, ndryshe s'mund me kanë.

17 PY. Pra, në 8 tetor 1998, është vrarë?

18 PË. Nji sqarim të shkurtë. Sot thoni është vrarë, kurse këtë
19 punë e ka sqaru ma së miri mjekësia ligjore e EULEX-it. Në
20 autopsi që ia ka ba, nuk është dalë i vrarë --

21 PY. Prit një çast, Dëshmitar. Nuk kam thënë unë që është
22 vrarë. E ke thënë ti te deklarata. Ke thënë që Abedini vdiq
23 pak kohë më pas.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtoj, është keqkuptuar
25 deklarata.

- 1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
- 2 Z. MISETIC: [Përkthim]
- 3 PY. Dëshmitar, unë dua ta sqaroj tani, si vdiq Abedin Rexha?
- 4 Si vdiq Abedin Rexha?
- 5 PË. Mjekësia ligjore e EULEX-it e ka vërtetue që ka vdek
- 6 prej, e ka lëshu zemra. Prej Zotit.
- 7 PY. Në rregull. Pra, ai vdiq pak kohë pasi ndodhi kjo
- 8 ngjarja, që i ke përshkruar ti Prokurorisë, kështu?
- 9 PË. Ai ka vdek aty ku ka vdek, por nuk ka vdek prej pushke,
- 10 ka vdek prej zemre. Qysh e ka pru mjekësia ligjore e EULEX-it.
- 11 Aty s'jam kanë.
- 12 PY. Në rregull. Ta marrim hap pas hapi. Siç ke thënë dhe te
- 13 ky paragrafi, vëllai të ishte plagosur, më 6 gusht --
- 14 PË. Po.
- 15 PY. -- dhe ti po e çoje, në Mitrovicë për mjekim në spital,
- 16 kështu?
- 17 PË. Po, po.
- 18 PY. Në atë kohë Mitrovica kontrollohej nga serbët, apo jo?
- 19 PË. Sigurisht.
- 20 PY. Kur të ndaluan, kur të ndaloi Sabit Geci, Sabit Geci të
- 21 pyeti ty, të pyeti ty si kalove ti, si hyre ti në territor
- 22 serb për të çuar vëllain tënd për mjekim, kështu?
- 23 PË. Po, shif. Sabiti ka mujt me fol çka ka desht. Se Sabiti e
- 24 kishte dajakun në dorë. Edhe po ai ish ndalimi, fjala e parë e
- 25 Sabitit, "adhurues i presidentit Rugova". E masanej ai ka fol

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 58

1 gjithçka, ma ka sha edhe nanën. Ju lutem, nuk është fjala ça
2 ka thanë masanej, por është fjala pse më ka ndalu në Kukës, në
3 Krumë, mendoj unë.

4 PY. Për momentin ne duam të fokusohemi te faktet. Çfarë ke
5 parë, çfarë ke dëgjuar, dhe veçanërisht çfarë të tha ty Sabit
6 Geci. Dhe, pyetja ime e parë është kjo. A pajtohesh me mua që
7 kur të ndaloi Sabit Geci, ai të pyeti ty, ndër të tjera, "Si
8 arrite ti të hysh në territorin serb për të marrë trajtim
9 mjekësor për vëllain?", kështu?

10 PË. Më shtitë me qesh pak, por e mirë edhe kjo, se për
11 shëndet ndoshta. Përmes serbëve, ka pas punë vetë,
12 bashkëpunëtor i serbëve është kanë vetë Sabit Geci në kohë të
13 gjatë, edhe ata e kanë lëshu prej burgut të Prizrenit Sabitin.
14 Po.

15 Këtu, Sabiti mu më ka ndal si adhurues i presidentit
16 Rugova, pra, do t'i flas dhe tri fjali të shkurtra. Kur më
17 kanë qit me 20 maj në gjyq në Kukës, akuza jeme është kanë:
18 Adhurues i presidentit Rugova, shok i Ahmet Krasniqit që e
19 vranë në Tiranë më 21 shtator. Ndërsa Rugovës ia qitën bombën
20 dy herë, edhe vëllai i Haki Imerit që e vranë më 2 nëntor
21 1999. Edhe shok i shtatë vëllaznive. Këtu katër akuza i kam
22 pas prej Sabit Gecit me shkrim.

23 Kukësi është, gjykata është, urdhnoni.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Sekretar i seancës, vendosim në
25 ekran materialin SITF00013352 deri në 00013368 RED3, edhe

1 anglishten edhe shqipen.

2 PY. Dëshmitar, kjo është deklarata që i ke dhënë policisë së
3 EULEX-it më 6 tetor 2009.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë tek faqja 3 në anglisht
5 dhe faqja 4, nga fundi, tek shqipja. Shkojmë më poshtë ju
6 lutem, tek anglishtja. Edhe shqipja.

7 PY. Dëshmitar, këtu thuhet, tek anglishtja të paktën:

8 "Më pyeti Sabit Geci si munda unë ta çoja vëllain tim pas
9 aksidentit tek spitali në Mitrovicë. Unë i thashë se kisha
10 frikë se mos vdiste, se kishte humbur shumë gjak, kishte pas
11 hemorragji.

12 "Prandaj unë vendosa të vozisja drejtpërsëdrejti në
13 punktin serb.

14 "I thashë Sabit Gecit çfarë ndodhi më pas. Fillimisht na
15 keqtrajtuan serbët derisa ndërhyri një komandant dhe mbajti
16 anën tonë. Policia serbe na çoi më pas në stacionin policor të
17 Mitrovicës.

18 "Fillimisht policët serbë deshën të na vrisnin. Një
19 komandant me emrin Gile sidoqoftë tha që do ta çonte vëllain
20 tim në spital. Ndërsa mua më mbajtën në stacionin e policisë."

21 Dëshmitar, a ju kujtohet tani që Sabit Geci të ka pyetur
22 për këtë gjë, dhe ti i ke thënë policisë të UNMIK-ut që Sabit
23 Geci të ka pyetur ty si munde ti ta çoje vëllain tek spitali
24 në Mitrovicë?

25 PË. A muj tash?

1 PY. [Nuk ka përkthim].

2 PË. Kur m'u ka plagu vëllau, e kam çu te infermieri në
3 Izbicë. Ia ka lidh komën, ia ka dhanë një injekcit të
4 dhimbtvet, edhe më ka thanë, "Imer, dy mundësi janë. O me e çu
5 në spital, o me e lanë me vdek. Me e çu në spital, u vrasin të
6 dyve, është e mundshme pshtoni". Atëherë, me e ndi vëllau që
7 kanka një rrugëdalje, ish punë e rand mos me vepru. I kam tha,
8 "Hajde vëlla, hajde, me ndihmën e Zotit". M'u ka lut ma, "Lemë
9 të vdes", s'kam mujt me e lanë vëllaun me vdek. E kam marrë,
10 edhe jam shku drejt në punkt në Runik.

11 Për fat të Zotit, unë e njoh kroatishten mirë se kam
12 ndejt në Kroaci. Domethënë, i ka do dallime, u kanë, s'di me
13 jua nda far prej gjuhe, por jam marrë vesh me ta. Aty është
14 dalë një magjyp, se tash do e çojmë deri në fund. U ndal një
15 magjyp, polic, edhe e pa që jam ngusht shumë. Isha pa këmishë
16 nalt. E kisha mbulu vëllaun se njërt e kish hup gjakun. Tha,
17 magjypi tha --

18 PY. Dëshmitar, që të jemi të qartë. Ju, po jua them, nuk po
19 ju kritikoj unë atë që keni bërë me vëllain tuaj. Është gjëja
20 më normale që do bënte çdo njeri. Dua të jem i qartë për këtë.
21 Unë dua të di çfarë ka dash të di Sabit Geci prej teje. Dhe
22 çfarë pyetjesh të ka bërë Sabit Geci kur të ka ndaluar. Këtu
23 do përqendrohemi ne.

24 Dhe unë të tregova në ekran se çfarë i ke thënë ti
25 policisë të UNMIK-ut në 2009. Pra, a e mban mend ti që i ke

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 61

1 thënë policisë së UNMIK-ut atëherë në 2009, që Sabit Geci të
2 ka pyetur ty, po si arrite ti të marrësh trajtim mjekësor për
3 vëllain tënd? E mban mend këtë?

4 PË. Me kerr kam shku. Edhe ma kanë marrë kerrin edhe më kanë
5 çu me kerr të policisë atje. Por Sabiti ndoshta ka desh me e
6 ditë mos ka qëllu ndonjë jaran i tij.

7 PY. Mirë, mirë. Por po të bëj një pyetje që do "po" ose "jo".
8 Sabit Geci, a të pyeti ty atëherë si munde ti ta çoje vëllain
9 në Mitrovicë, si arrite ti? Të pyeti apo s'të pyeti? Po apo
10 jo?

11 PË. I nderum. Vendosa me dekë edhe shkova. Kjo është e tëra.
12 Zoti na pështoi, sot jam këtu.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
14 Dëshmitar. Pyetja është shumë e thjeshtë. Dhe kërkon një
15 përgjigje me "po" ose me "jo". Të lutem, dëgjoje me vëmendje
16 pyetjen, nuk na duhen detajet e mëtutjeshme. Po të kemi nevojë
17 ju pyesim vetë. Dëgjoje dhe një herë pyetjen dhe përgjigju me
18 "po" ose me "jo".

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të
20 sigurohem që dokumenti të mos jetë për publikun.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jo, nuk ishte dokument
22 publik.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

24 PY. Dëshmitar, edhe një herë. Sabit Geci atëherë a të pyeti
25 ty, a të pyeti ai ty, si munde ti, si munde ti ta çoje vëllain

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 62

1 për mjekim në Mitrovicë, si arrite ti të hyje në Mitrovicë? Të
2 ka pyetur apo jo Sabit Geci?

3 PË. Nuk e di a më ka pyet. Por policia serbe na kanë çu me
4 kerr të ushtrisë.

5 PY. Pra, deklarata që ke bërë në 2009, për EULEX-in, është ti
6 po thua që nuk e mban mend, pra ti nuk mban mend që ti kesh
7 thënë policisë së EULEX-it nëse të ka pyetur Sabit Geci si e
8 çove vëllain në Mitrovicë, këtë po thua?

9 PË. Që është e shkrume aty që ka shkru policia e EULEX-it,
10 unë e kam thanë gjithmonë. Të tana janë ato të vërteta, ama
11 nuk po besoj çka ka shkru Sabit Geci në qoftë se është, janë
12 të tana rrena se është spiuni ma i madh. Tradhtari ma i madh i
13 dheut në Ballkan është Sabit Geci.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
15 pyetja është shumë e thjeshtë. Dëgjoje pyetjen --

16 DËSHMITARI: Më falni.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] -- dëgjoje
18 pyetjen dhe përgjigju vetëm pyetjes.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

20 PY. Pra, Dëshmitar, e kuptoj nga përgjigja juaj që është,
21 nëse është shkrujt dikund, është thënë atëherë.

22 Po a është e vërtetë, po kështu, se ai ju ka akuzu se keni
23 gisht në vrasjen e mikut të tij, Abedin Rexhës. Nuk po them,
24 nuk po them se është e vërtetë, nuk po them unë që është e
25 vërtetë. A ju ka akuzu ai apo jo gjatë ndalimit tuaj? Këtë

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 63

1 po pyes.

2 PË. Kurrë. Kurrënjiherë.

3 PY. Po, Dëshmitar, disa prej njerëzve të cilët kanë të burgos
4 bashkë me ju, kanë dëshmu këtua, se e kanë ndigju Sabit Gecin
5 që t'ju ketë bë juve pyetje për përfshirjen tuaj siç
6 pretendohej nga ai në vdekjen e Abedin Rexhës. Se duhet edhe
7 një herë ta kuptoni. Nuk po them unë, pra, nuk po jua bëj
8 pyetjen që a është kjo e vërtetë apo jo, që keni pas ju gisht
9 apo jo? Unë po pyes a është e vërtetë që Sabit Geci i ka bo
10 këto akuza ndaj jush apo jo?

11 PË. Betohe në Zot që jo.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, ju lutem të kalojmë në
13 seancë private.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
15 seancë private.

16 [Seancë private]

17 [Seancë private teksti i fshirë]

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 64

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 65

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 66

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 67

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 68

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 69

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
3 jemi në seancë publike. Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
5 Z. Avokat, vazhdoni.

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, e konstatojmë që nuk keni marrë pjesë në
8 varrimin e Abedin Rexhës, Sandokanit. Pak pas vdekjes së tij,
9 ju keni shku në Kroaci, kështu?

10 PË. Nuk e di datën kur ka vdek ai, por unë kam shku dikund
11 kah mesi i të dymbëdhjetit muaj.

12 PY. Dhe ju thatë se arsyeja pse keni shku në Kroaci ka qenë
13 për arsye ekonomike?

14 PË. Sigurisht.

15 PY. S'kishte të bënte fare me faktin që njerëzit fillun me bo
16 akuza lidhur me lidhjen tuaj, siç e pretendonin ata, me
17 vdekjen e Abedin Rexhës?

18 PË. Po kjo s'ka ndodh atje dhe as nuk e kam dëgju prej
19 kërrkuj. Por ato të tana po i dëgjoj këtu te ju. Atje kurrë
20 jo. Dhe më vjen keq, që e nxisni një grindje që nuk ekziston.
21 Kjo s'pritet prej jush. Se s'jeni të vërtetë. A jeni kanë ju
22 në Kosovë ndonjiherë? Ju lutem.

23 PY. Dëshmitar, nuk po përpiqemi që të grindemi këtu, pra
24 është thjesht, po përpiqem që të konstatoj nëse Sabit Geci ju
25 ka bo apo jo pyetje lidhur me këtë. Unë ju falënderoj shumë --

1 PË. Kurrë.

2 PY. -- që më jeni përgjigj pyetjeve. Në rregull, faleminderit
3 shumë.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, këtu mbarojnë dhe
5 pyetjet e mia.

6 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

7 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje, i nderuar Gjykatës.

8 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Kemi disa pyetje, mbase 15
9 a 20 minuta, jo më shumë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
11 vazhdoni.

12 Pyetje të palës tjetër nga znj. S. Alagendra:

13 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

14 PY. Z. Dëshmitar, mirëmëngjesi.

15 PË. Mirëmëngjes.

16 PY. Më quajnë Sandra Alagendra dhe përfaqësoj, pra jam
17 Avokate Mbrojtëse e Jakup Krasniqit. Kam disa pyetje, shumë
18 pak pyetje, lidhur me ju sot, duke filluar pikësëpari me këtë
19 pyetje. Ju vetë nuk jeni takuar asnjëherë me z. Jakup Krasniqi
20 gjatë luftës, sidomos?

21 PË. Jo.

22 PY. Dhe, në fakt, deri, pra në fund të tetorit të 2009, kur
23 ju ka marrë në pyetje dhe EULEX-i, ju ende nuk ishit takuar me
24 të, kështu është?

25 PË. Kurrënjëherë s'jam taku me Jakup Krasniqin.

1 PY. Dua që të flasim për një pikë të caktuar. Ka të bëjë me
2 dëshminë tuaj këtu që mbështetësit e Rugovës ishin vënë në
3 shënjestër për t'u vrarë.

4 Pra, zotëri, ju publikisht a e keni akuzuar z. Krasniqi
5 që ka vrarë Xhevat Isufin sepse mendohej se ishte mbështetës i
6 Rugovës? Kështu është, apo jo?

7 PË. Po.

8 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, atëherë, që të
9 kërkoj që dokumenti me numër DJK 00984 të dalë në ekran.
10 Bashkë me përkthimin në anglisht.

11 PY. Po të shihni në ekran përpara jush, zotëri, unë në fakt
12 do t'jua lexoj paragrafin që ju citon juve ku thuhet aty:

13 "Jakup Krasniqi ka shkuar te Xhevat Isufi në Vidishiç, në
14 zyrën e tij, e i ka thënë çka është kjo fotografi e Rugovës?
15 Ai i ka thënë 'Është foto e presidentit'. 'Ose hiqe ose e
16 nxjerr revolen edhe të vras. Do të kesh pasoja'. Pas tri
17 ditësh është vrarë Xhevat Isufi."

18 Kështu keni deklaru ju në televizion, publikisht, apo jo,
19 zotëri?

20 PË. Unë jam kryetar i shoqatës "Thirrje për Drejtësi".

21 Njerëzit janë lajmëru te unë. Janë bo shumë vrasje në këtë
22 drejtim. Është shumë e vërtetë. Këtu edhe njeriu që është
23 kryetar për të drejtat e njeriut në Mitrovicë, Halit Bajrami,
24 ka vërtetue që është vra prej shqiptarëve. Por, shokët e
25 tijna, shokët e Xhevatit kanë thanë që bash qeshtu që kam than

1 unë. Se zotëri Jakup Krasniqi u shku, i ka thanë hiqe këtë
2 fotografi se të vras. Ka thanë, jo, këtë me e prek s'ban.
3 Atëherë, ka ndodh vrasja mbas dy-tri ditësh. Është shumë e
4 vërtetë.

5 PY. Pra, zotëri, ju e dini, apo jo, që në vitin 2013, z.
6 Isufi mori statusin e Heroit të Kosovës, nga Presidenti i
7 Kosovës. Besoj për këtë jeni në dijeni?

8 PË. Po, shif. Ata kanë marrë, kanë marrë tituj të heronjve
9 shumë. I kanë dhanë titull edhe Ilir Konushevcit. Por, këqyrni
10 të dhanat qysh është i vrarë. Ju lutem. Këtu janë bo shumë
11 gjana. Kanë vra njerëz, unë e kam tanë të shënume edhe jua kam
12 dorëzue Gjykatës këtu kur jam kanë me dhanë deklaratën. Ia kam
13 dhanë prej ndoshta 100, nja 60 të vramë, edhe shumë të
14 keqtrajtum të burgosur, të arrestum. Nji ndër ta i arrestum
15 unë. Nji ndër ta i vram vllau jem, ku ta di unë.

16 PY. Faleminderit. Ju lutem, me shumë respekt, do t'ju kërkoja
17 që t'u përgjigjeni me po ose me jo pyetjeve të mia. Po të kem
18 nevojë për shpjegime, do t'jua kërkoj pastaj.

19 Jeni ju në dijeni që z. Isufi në fakt është vrarë në një
20 pritë më 3 janar të vitit 1999, dhe se gjatë të njëjtit
21 incident Zymber Halimi, ndryshe i njohur dhe si komandant
22 Besi, është plagos? Pra, jeni në dijeni të kësaj, vetëm "po"
23 ose "jo".

24 PË. Vetëm "po" edhe "jo" nuk muj me sqaru kurrgjë. Unë e di
25 që kur kanë desh me vra nji, në kjofshin kanë dy, tre, i kanë

1 vra të gjithë.

2 PY. Kur ju i keni bo këto akuza publikisht në Kosovo TV, pra
3 në televizionin kosovar, më falni, a ju kujtohet që i biri i
4 z. Isufi ka qenë në program? Jo, është lajmëru në program, dhe
5 ai ju ka qujt, dhe unë po citoj atë --

6 PË. Po.

7 PY. Ju ka citu që jeni gënjeshtar, ju ka thënë gënjeshtar.

8 PË. Po.

9 PY. A ka ndodh kjo apo jo?

10 PË. Ka ndodh.

11 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem të shohim videon.

12 DËSHMITARI: Shkurt. Ai ka thirr edhe ka thanë, "shpifës".
13 Por, ma vonë e ka pranë, ka thanë, "Më ka thirr dikush në
14 telefon, jam kanë i detyrum me i thanë Imer Imerit kështu, se
15 është e vërtetë çka ka ndodh".

16 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem që të shohim
17 videon, DJK00988, ju lutem. Ju kemi dhënë dhe transkriptin në
18 anglisht, edhe në shqip.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjithë
20 videon do e shikojmë?

21 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Është një video shumë e
22 shkurtër, rreth dy minuta.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 [Luhet videoincizimi]

25 "Faleminderit për mundësinë. Jam Esat Jusufi, djali i [E

1 padëgjueshme] më shqetësoi...”

2 DËSHMITARI: Po unë ju thashë që këtë e ka thirr në
3 telefon njëri e ka shti me m’u kundërvy mue. Edhe ma vonë më
4 ka kërku falje.

5 [Luhet videoincizimi]

6 “Imer, mysafiri që keni të ftuar aty në studio, që
7 shpif...

8 “Imer Imeri.

9 “[E padëgjueshme] Emrin nuk ia di qysh e ka. [E
10 pakuptueshme] e kam pa dhe ma herët, [E padëgjueshme] me thanë
11 që shpif [E padëgjueshme]. Shpifës [E padëgjueshme] krejt asaj
12 se çka thotë.

13 “Veç pak, djali vetë tha. U thirrin djalin e vet. Me, veç
14 pak, Gaz, të lutem. A djali i personit të cilit tha e ka vra
15 Jakup Krasniqi, të lutem. Kjo është e randë. Kjo është e
16 randë. Të lutem përderisa ia përmendi emrin e djalit është
17 këtu dhe mund ta thotë. Të lutem.

18 “Okej, domethënë Imer Imerin kurrkush prej familjes tonë
19 nuk e njeh. Nuk e din. Nuk ka marrë asnjë shënim prej neve,
20 domethënë, si familje as [E padëgjueshme] nuk e kemi
21 domethënë, në asnjë [E padëgjueshme] as një [E padëgjueshme]
22 që ka ndodh. Domethënë, gjatë luftës. Domethënë, baba jem ka
23 qenë aktivist prej viteve 1980, aq sa unë e mbaj mend.
24 Domethënë, që kam mbërri me e njoft prej shokëve të vet, edhe
25 pjesa tjetër çkadoqoftë që ka ndodh në luftë, domethënë, baba

1 jem nuk ka qenë rastësisht në luftë. [E padëgjueshme] ka qenë
2 i kyçun në shumë ma herët. Edhe tash, e del një shpifës, një
3 gënjeshtar, çfarë z. Imeri, në studio, edhe të shpifë se kinse
4 ky e ka vra, Jakup Krasniqi, babën tem, domethënë është një
5 gënjeshtër e kulluar. Edhe i kisha lut, zotërinjtë në studio,
6 edhe ata të cilët panelistët, domethënë, mos të lejojnë kesi
7 [E padëgjueshme] nëpër studio edhe të nxisin urrejtje mes
8 familjeve, mes dëshmorë. Domethënë kanë mbet vetëm dëshmorët
9 ata që nuk janë njollos, nuk mbet njëri i luftës nuk është
10 njollos prej atyne që nuk e dojnë lirinë, prej atyne që nuk ia
11 kanë pas frikën lirisë. Domethënë, tash kanë nis edhe me
12 dëshmorët me u marrë. Kjo është e tepërt, domethënë, është e
13 paskrupullt kjo. [E padëgjueshme] domethënë, nuk e ka kërku
14 kurrkush, edhe e kisha lut që mos të nxë kurrë emrin Xhevat
15 Jusufit në gojë.”

16 “Faleminderit, juve. Esat...”

17 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. Z. Dëshmitar, ju kujtohet i gjithë ky incident? “Po” ose
19 “jo”. Ju kujtohet?

20 PË. Po, më kujtohet. E kanë thirr në telefon edhe e kanë
21 detyru me i fol qeto fjalë. Ju lutem. Ju epma mundësinë mu
22 t’jua numëroj sa të vranë janë, e kush janë të vranë, e çka u
23 bo, e krejt si është puna. Unë Zotit ia kam dhanë besën që do
24 të dëshmoj deri në vdekje. Unë nuk e di qysh jam gjallë sot,
25 Zoti më ka pru këtu, para drejtësie.

1 Këtu u bo turli trike. Këto dy herë ia kanë ndërru punën
2 këtij djalit. Për me ia mbyll gojën. Ju lutem, ka shumë kësi
3 rastesh që u kanë dhanë vend pune, u kanë dhanë gjithçka me ju
4 mbyll gojën. Mu më vjen keq shumë --

5 PY. Z. Dëshmitar. Z. Dëshmitar, ju lutem.

6 PË. -- ky për babës së vet ça ka bo.

7 PY. Faleminderit.

8 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
9 që dokumenti DJK00988, video dhe transkripti përkatës, të
10 pranohen në prova gjyqësore.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
12 kundërshtim?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me
15 numër DJK0098 -- deri ku ishte numri, thatë? [Mikrofoni
16 çaktivizuar]. Në anglisht dhe në shqip.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Nëse mundet. Dokumenti
18 numër DJK00988 dhe transkripti përkatës në anglisht dhe në
19 shqip, do të marrin numrin e provës materiale 4D00079. Dhe
20 aktualisht janë të klasifikuara si publike.

21 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

22 PY. Z. Dëshmitar, a keni një armë, një armë brezi të cilën
23 jua kanë dhënë hetuesit e EULEX-it?

24 PË. Ma së pari, hetuesit e UNMIK-ut ma kanë dhanë, [E
25 pakuptueshme] të EULEX-it, tash ma jep qeveria jonë. E kam.

1 PY. Pra, hetuesit e EULEX-it ju kishin dhënë një armë, kështu
2 po thoni, po?

3 PË. Po.

4 PY. E keni ende atë armë?

5 PË. I kam tri armë -- pesë.

6 PY. Jo, vetëm këto të EULEX-it, sa ju ka dhënë EULEX-i, sa
7 armë?

8 PË. Më ka dhanë një revole, EULEX-i. Ma ka dhanë UNMIK-u, ju
9 lutem. Por prej atëherë e kam. Prej që m'u ka vra vllau.

10 PY. Jua dhanë përpara apo mbas intervistave?

11 PË. Ju lutem, m'u ka dhanë po në 2000, ashtu kur m'u ka vra
12 vllau. Ata ma dijsin krejt periudhën time qysh jam burgos,
13 edhe, ju lutem, si dëshmitar, unë gjithnjë një mbrojtje e kam
14 pas prej UNMIK-u, prej EULEX-i edhe sot besoj prej Gjykatës
15 Speciale. Pse? Ju e dini që në Kosovë janë vra mbi 30
16 dëshmitarë. Që këta 30 dëshmitarë nuk kanë dëshmu për Serbinë.

17 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më
18 thonë që ka ndaluar transkripti.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

21 PY. Dëshmitar, nëse nuk e kam gabim, i keni thënë ZPS-së këtu
22 se hetuesi i huaj, pra që jua ka dhënë këto armë, njëri prej
23 tyre quhet Josef, kështu?

24 PË. Edhe Wolfgang Orden, dy ishin policë këta, të UNMIK-ut,
25 njerëz të mirë, punëtorë të mirë, që na kanë ndihmu shumë.

1 PY. Ju kanë dhënë edhe ndonjë vërtetim apo dhe ndonjë
2 procesverbal për këtë që jua kanë dorëzuar armën, jua kanë
3 dhënë?

4 PË. Po, sigurisht që unë e kam lejen, me fotografi.

5 PY. Këta hetues, ose më ndryshe, u lejohej këtyre hetuesve
6 t'u jepnin armë dëshmitarëve, dini gjë ju për këtë?

7 PË. Kjo është kanë fill mbas lufte, është kanë në UNMIK. Unë
8 u tham, vitin 2000. Prej vitit 2000 e këndeje, janë 24 vjet,
9 zonjë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A do dilni
11 diku me këtë?

12 DËSHMITARI: Atëherë, por janë thanë gjanat ndryshe.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
14 relevancë?

15 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Ka të bëjë me besueshmërinë
16 e dëshmitarit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk shohim
18 asgjë këtu lidhur me besueshmërinë.

19 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Sipas nesh, ka lidhje
20 me besueshmërinë dhe mund t'ju jap parashtrim me këtë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për momentin
22 nuk shohim asnjë lloj relevancë, ju lutem vazhdoni.

23 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

24 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga znj. Iodice

Faqe 79

1 shtesë, Prokuroria?

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Vetëm një, një pyetje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëgjon, na
4 dëgjon?

5 DËSHMITARI: Po.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kam një pyetje të shkurtër.

7 Pyetje vijuese nga znj. Iodice:

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

9 PY. Lidhur me këtë që sapo thatë për dëshmitarët që janë
10 vrarë, cili është, çfarë është përshtypja e përgjithshme në
11 Kosovë për dëshmitarët që duan të japin dëshmi?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj themelësinë e kësaj
13 pyetjeje, çfarë lidhje ka këtu përshtypja e gazetarëve?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
15 Vazhdoni.

16 Përsëriteni pyetjen.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

18 PY. Z. Imeri, ju përmendët dëshmitarët që janë vrarë. Në
19 përgjithësi çfarë perceptimi përcjellin media dhe gazetarët
20 për dëshmitarët që vijnë këtu për të dhënë dëshmi, si
21 trajtohen ata?

22 PË. Znj. Prokurore, unë kam dhanë edhe në deklaratën para
23 juaj, dje apo pardje. Ne si dëshmitarë, po na quajnë
24 tradhtarë. Ne nuk jemi tradhtarë. Unë nuk jam tradhtar që
25 dëshmoj për vëllaun tim, për veten time. Por dhe të gjithë ata

1 të tjerët që dëshmojnë për të dashurit e tyre nuk janë
2 tradhtarë. Por, na e kanë ngjitur këta gjoja që ne po
3 konsultohem me BIA-n serbe.

4 Të nderuar Gjykatës, e të gjithë ju. Ne jemi të
5 vetëdijsëm. Ne jemi të familjeve të mira, kombëtare,
6 atdhetare. Ne jemi të vetëdijsëm që Serbia na i ka vra
7 12,000, 13,000 njerëz. Na jemi të vetëdijsëm që Serbia na i
8 ka kallë 150,000 shtëpija. Na jemi të vetëdijsëm që na i ka
9 dhunu 20,000 gra. Qysh na konsultohem me ta? Por, njerëz që u
10 vranë, të nderuar, Ahmet Krasniqi, gjatë lufte, Enver Maloku,
11 gjatë lufte, edhe niset me vrasjen e vëllait tim Haki Imeri,
12 mbas lufte, e përfundojnë, Zoti ta dijë, 500, 600 vrasje, a
13 100 i kam të shënume unë në regjistrat e mia si kryetar
14 shoqate "Thirrje për drejtësi".
15 Edhe janë vra qeta dëshmitarë që kanë dëshmu, për qeta njerëz,
16 këta janë vra. Edhe krejt që këtyne njerëzve që ju kanë vra të
17 dashunit e tyre, kurrënjherë, asnjë ngushëllim kujt, as nuk
18 janë përmend. Pse u vra filani, a pse u vra fisteku? Veç, "mos
19 baj za për këta". Edhe një, ju lutem, mos më keqkuptoni. Sylë
20 Hoxha, prokuror, në Kosovë ish-ushtues i detyrës,
21 kryeprokurorit të Kosovës, unë e kam dëgju në televizor edhe e
22 kam këqyr, ka thanë: "Njerëz që i vret shteti, nuk zbulohen se
23 me desht policia e Kosovës i zbulon për një javë, nesërit."

24 E kam shkru një shkrim të madh ia kam çu Sylë Hoxhës, ia
25 kam çu Evnver Pecit, kryetari i gjykatës. Ia kam çue EULEX-it,

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 81

1 edhe ia kam çue ambasadës së Amerikës, të cilën e falënderoj
2 edhe më ka thirr në të dytën ditë. Edhe jam shkue e i ka marrë
3 për bazë të gjitha edhe ka thanë, "Si të fillojë Gjykata
4 Speciale njeri i parë që të vjen kem me të thirrë". E mbajtën
5 fjalën, e vërteta.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni pyetje
7 tjetër?

8 Trupi Gjykses? Gjykatësi Barthe.

9 Pyetje nga Trupi Gjykses:

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar. Më
11 dëgjon, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam disa pyetje, por do të
14 doja që të kalonim në seancë private për pyetjet e mia.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
16 seancë private.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 83

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 85

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 86

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Imer Imeri (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 87

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, Dëshmitar,

17 dëshmia juaj përfundoi. Tani mund të largoheni nga salla e

18 gjyqit. Faleminderit që erdhët, që ndatë informatat që kishit.

19 Tani mund të dilni nga salla bashkë me Asistenten e seancës,

20 dhe ju urojmë gjithë të mirat.

21 DËSHMITARI: A u kry?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

23 [Dëshmitari largohet]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitari

25 tjetër a është gati? Sigurisht, pas pushimit të drekës në

1 goftë se është nevoja.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, dëshmitari i radhës mund të
3 fillojë vetëm nesër.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj këtë
5 gjë.

6 Po dua t'i them dhe një herë ekipeve të Mbrojtjes, kishit
7 kërkuar shtatë orë e gjysmë dhe përdorët një orë. Është pak e
8 papranueshme kjo. Duhet të na njoftoni të paktën paraprakisht.
9 Njoftoni dhe Prokurorinë që të përgatitemi, se mund të kishim
10 pasur tre javë këtë dëshmitar -- mund të kishim pasur tre
11 dëshmitarë këtë javë, në vend që të kishim vetëm dy. Ju lutem,
12 përpiquni pak më shumë.

13 Në rregull, shihemi nesër në orën 9.00.

14 --- Seanca mbyllet në orën 12.47

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25